



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**LEGJISLATURA VIII**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Mbledhja nr.77

Prishtinë, më 30.04.2024, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Bekë Berisha, kryetar i Komisionit Enver Dugolli- nënkryetar i parë, Erxhan Galushi - nënkryetar i dytë, Shqipe Mehmeti Selimi, Mefail Bajqinovci, Arbër Rexhaj, Anton Quni, Dimal Basha, Hisen Berisha, anëtar.

**Mungoi:** Rashit Qalaj-anëtar.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Faton Krasniqi- ndërlidhës legjislativ mes Kuvendit dhe Ministrisë së Mbrojtjes, Besnik Fetahu (Grupi parlamentar i VV), Laurenta Zogaj-Asistente në Komisionin Parlamentar

**Nga stafi mbështetës i komisionit:** Nur Çeku (koordinator), Zarë Aliu (zyrtare e lartë)

**Mbledhjen e kryesoi Bekë Berisha,** kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit me propozim amendamente për Projektligjin Nr. 08/L-225 për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
3. Shqyrtimi i raportit me propozim amendamente për Projektligjin Nr. 08/L-261 për mbrojtje nga zjarri;
4. Shqyrtimi i raportit me propozim amendamente për Projektligjin Nr. 08/L- 267 për letërnjoftimin;
5. Shqyrtimi i raportit me propozim amendamente për Projektligjin Nr. 08/L-274 për Shërbimet Private të Sigurisë.

6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr.08/L-296 për të huajt;
7. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes kornizë ushtarake ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë;
8. Formimi i grupit punues për hartimin e Rregullores së punës për Komisionerin Parlamentar për FSK;
9. Të ndryshme.

Në vijim të mbledhjes u kalua në shqyrtimin e pikave të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës.**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

### **2. Shqyrtimi i raportit me propozim amendamente për Projektligjin Nr. 08/L-225 për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.**

**Kryetari**, lidhur me këtë Projektligj, si Komision funksional kemi formuar grupin punues për shqyrtimin e tij dhe kemi pranuar raportin me propozim-amendamente nga Kryesuesi i grupit punues z.Enver Dugolli, gjithashtu janë bërë disa propozim amendamente nga z.Enver Dugolli dhe znj.Shqipe Mehmeti Selimi, për të cilat duhen të deklarohet Komisioni nëse i përkrah ose jo, pasi sipas Rregullores së Kuvendit duhet të përfshihen në raportin përfundimtar të Projektligjit. Fillimisht fjalën ia kalojmë z.Enver Dugolli-kryesues i grupit punues, pastaj anëtarët e Komisionit. Pas diskutimit e hedhim në votim raportin me propozim-amendamente.

**Enver Dugolli**, theksoi se grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, ka punuar si për asnjë ligj tjetër, ka mbajtur disa takime të grupit punues, dëgjim publik, vizitë studimore. Po ashtu janë dy propozime, një propozim nga znj.Shqipe Mehmeti Selimi si dhe disa propozim amendamente nga unë ( Enver Dugolli). Sa i përket propozimit të znj.Shqipe Mehmeti Selimi, ka zënë vend në raportin final dhe si i tillë bartet në seancë, ndërsa nuk është e nevojshme që të prezantohet si amendament i veçantë në Komision pasi figuron në raportin final. Pra për titullin e Projektligjit, deputetja Shqipe ka propozuar që të fshihet “të sigurisë” që të mbetet vetëm Agjencioni i Mbrojtjes, ndërsa amendamentet e paraqitura nga unë, janë shkruar në formën si i kam shkruar

**Kryetari**, për disa amendamente i kemi disa mospajtime, po dëshirojmë të sqarojmë situatën.

**Anton Quni**, faleminderit Kryetar, sa i përket këtij Projektligji, na ka marrë më së shumti kohë, me krejt përvojën që kemi në Komisionin për Siguri. Nuk dua të hy në çështjet objektive dhe subjektive. Këto rekomandime paraqiten si rekomandime të grupit punues, që është në shpërputhje me realitetin, pasi brenda grupit punues ka pasur qëndrime të ndryshme dhe nuk e kuptoj si mundën me dalë këto propozime, si vendim i grupit, kur nuk është votuar fare. Anëtarët kanë evidentuar mendime të ndryshme, kemi dëgjuar njëri tjetrin, por nuk kemi dalë në konkludime të përbashkëta të grupit, pastaj ti qëndrojmë mbrapa të gjitha këtyre propozimeve që janë prezantuar. Nga 57

amendamente, të cilat besoj se janë të arsyeshme, të pranuar dhe të kuptuara edhe nga sponsorizuesi i Projektligjit, janë tre amendamente për të cilat nuk kam pajtueshmëri. Është amendamenti i parë, i cili flet për titullin e këtij Projektligji, ku kërkohet që ky Agjencion të quhet Agjencioni i Inteligjencës së Mbrojtjes. Versionin e propozuar nga sponsorizuesi, duhet ta reduktojmë vetëm në Agjenci të Inteligjencës. Nëse e keni një vëmendje të veçantë në të gjitha nenet, do të duhet të kuptoni që ky Agjencion e ka përsipër jo vetëm veprimtarinë e inteligjencës por edhe të sigurisë. Nëse e heqim termin siguria, do të duhet ti hynim nga fillimi Projektligjit dhe të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë, do të duhej ti largonim nga Projektligji. Në këtë çështje kanë punuar ushtarakët, profesionistët dhe kanë bashkëpunuar me agjencionet si motra, andaj nuk e shoh të arsyeshme që ne si anëtar të Komisionit, që nuk jemi mjaftueshëm të thirrur të diskutojmë emërimin e Projektligjit, duhet të kemi besim te sponsorizuesi për emërtimin e Ligjit. Amendamenti tjetër diskutabil është, Amendamenti 32, i cili flet për gradën ushtarake të drejtuesit të këtij Agjencioni, ne e kemi një amendament që propozon që Drejtori i Përgjithshëm i Agjencionit, është oficer me gradën kolonel, është si çështje paradoksale, pasi ne po e ngrisim nivelin e Agjencionit, nga Departamenti, ku në kuadër të departamentit është udhëhequr nga personi me gradën Gjeneral, pra ne tani po e ngrisim në nivel Agjencie, ndërsa e ulim gradën e drejtuesit të saj. Brenda Ministrisë së Mbrojtjes janë këto drejtori, Drejtoria për Politikë të Mbrojtjes, Drejtoria për Inteligjencë dhe Siguri, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Mbështetjes. Çdo të dytën drejtori, udhëheqës është zyrtar civil, kurse të tjerët janë ushtarak, dhe ushtarakët janë me gradë gjeneral, kurse kuadrot civile janë analog me gradat civile me gjeneral. Do të ishte e pakuptimtë, që nga niveli i Drejtorisë të kalohet në nivel të agjencionit, pasi nuk janë më vartës të Sekretarit por janë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe ne e ulim gradën e drejtuesit të Agjencionit. Prandaj unë jam për atë që grada e drejtuesit të Agjencisë të jetë e nivelit të Gjeneralit, duke mos folur edhe për sensitivitetin e kësaj veprimtarie dhe rëndësisë së misionit. Çështja e fundit është kalimi i kompetencave nga Departamenti tek Agjencioni, në Nenin 45 tek dispozita që është amendamenti 54, thuhet që brenda dymbëdhjetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Agjencioni do të filloj të funksionoj. 2. Drejtoria për Inteligjencë dhe Siguri, me hyrjen në fuqi të Ligjit, pushon së funksionuari. Çfarë do të thotë kjo? Nëse themi ne së ky ligj, hynë në fuqi brenda një viti, do të thotë që ne e krijojmë mundësinë që njëmbëdhjetë muaj, mos të ketë as departament, as agjencion, i cili do e mbuloj këtë fushë. Ndoshta për ata që nuk e njohin këtë fushë, do të duhej normale, por ata që janë profesionist, kjo do e cenonte në masë të madhe sigurinë nacionale, pra për një vit nuk do të kishim këto departamente dhe Agjencionin i cili do i siguronte të gjitha ato analiza, përfundime në fushën e inteligjencës. Ky duket një propozim që e rrezikon sigurinë nacionale, pra departamenti është inekzistent, pa fushë veprimtarie, i tërë ai kuadër që me vite ka punuar për ngritjen e kapaciteteve, sistemohen në detyrat e tjera dhe do të duhet të pritët një vit, derisa të nxirren kuadrot e reja dhe të mbulohet kjo fushë. Pra për amendamentin 1, 32 dhe 45 nuk jam i pajtimit që të kalojnë dhe duhet të qëndrojnë siç janë në Projektligj. Do të lutem edhe kolegeve që të kenë mirëkuptim.

**Kryetari**, për çështjet e ngritura e falënderoi z. Quni, tutje theksoi se ka marrë raportin edhe nga Ministria e Mbrojtjes nga njerëz adekuat, është konsultuar edhe me shumë njerëz për këto çështje edhe me kryesuesin e grupit punues për këtë Projektligj dhe ka konsideruar që në këtë situatë të sigurisë, në nivel global të bëhet kjo shprehje, nuk i kupton qëllimet pse duhet të bëhet dhe do të ishte mirë që kryesuesi i grupit punues, z. Enver Dugolli, të na sqaronte se a hoqi dorë nga këto

propozimet që i identifikoj z.Quni, pra çështjen e emrit, gradës si dhe çështjen e shkëputjes së zinxhirit të funksionimit për një vit?

**Enver Dugoll**, sa i përket çështjes së emrit, theksoi se e shpjegoi edhe proceduralisht, që deputetja Shqipe e ka bërë një amendament i cili do të përcillet deri në seancë, por meqë jemi marrë vesh, pasi në grup punuese, paradoksalisht kemi qenë katër veta dhe sugjeroj që në të ardhmen mos të jetë numri qift në grup punues, pasi asnjë vendimmarrje nuk quhet e dakorduar kur mund të ndahen votat 2/2, pra si kryesues e kam marrë përsipër që të përgatis këtë raport, duke i akomoduar edhe dakordimet që i kemi pasur në grup punues edhe mendimet që i kemi pasur, me kusht që amendamentet i tërheq, mirëpo raporti me propozim-amendamente i përmban ato që ne mendojmë, natyrisht i dakorduar edhe me ministrinë e Mbrojtjes, që ti votojmë dhe ti shtyjme përpara në shqyrtimin kryesor. Sa përket vërejtjes së parë, tek emërtimi, konsideroi që nuk e cenon përmbajtjen e Ligjit, nuk cungohet aspak, nëse i hiqet “dhe sigurisë” pasi qëllimi ka qenë i mirë, pasi Agjencioni i Inteligjencës së Mbrojtjes, ka specifika të veçanta të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen ndërsa me sigurinë janë të tjera institucione dhe nuk e përjashtojnë sigurinë. Pra një instrument që Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë e ka në dorë për të pasur informacione. Ndërsa sa i përket gradës, sa për njoftim, Ministria e mbrojtjes është në procesin e ristrukturimit dhe të gjitha pozitat do të jenë të baras vlefshme sikurse në ministrinë e tjera, dhe jo sikur tani që është në ministrinë e mbrojtjes që një shef i departamentit të ketë gradat, më të lartë se në ministrinë e tjera. Tutje vlerësoi se duhet të lirohem nga fenomen i pozitive të fryra të gjeneralëve, pra e kemi forcën pesë mijë veta, pra një kolonel e udhëheq një brigat, pra ideja është që fryma e zhvillimit të FSK-së dhe ministrisë së Mbrojtjes, të ulen pak këto pretendimet të fryra, për të cilat nuk kemi nevojë. Niveli i gradës Kolonel është i mjaftueshëm, ndërsa tek vërejtja e fundit që ishte, Amendamenti 54, tek shqetësimi që ngriti. Ideja është që ne po bëjmë një Agjenci të re dhe për ti dhënë mundësi të gjithëve, të gjithë personelit në FSK por edhe civil, të jenë të barabartë në aplikim. Pasi nuk mund të jetë i barabartë, ai që është brenda aktualisht, me atë që tenton të hyjë brenda. Pasi kemi dashur që të paraqitet një lloj barazie, pasi kjo barazi vlen edhe për punonjësit aktual, asgjë nuk e bënë më specialist, apo më profesionist se ai që nuk i ka ardhur mundësia që është në forcë, ndërsa s ai përket cenimit të sigurisë, që u tha nga disa koleg, edhe pse është e ekzagjeruar kjo, pasi në FSK, ekziston G2, i cili i mbulon të gjitha detyrat aktuale që i kryen Drejtoria për Inteligjencë dhe Siguri, për nevojat e FSK-së, përveç G2 ekziston edhe S2 edhe i mbulon mjaftueshëm. Ndërsa sa i përket kohës, nuk kemi thënë për një vit, pro kemi thënë brenda një viti, do të funksionalizohet Agjencia, pasi të implementohet ky ligj, brenda shtatë dite hyn në fuqi dhe Ministri i Mbrojtjes, mundet të emëroj menjëherë Drejtorin dhe pastaj i merr kompetencat dhe detyrat për funksionalizimin e kësaj Agjencie, brenda një viti. Pra mundet brenda tre muajve, pro kjo është ideja që është menduar. Nuk kam hequr dorë nga asnjë amendament, të gjitha amendamentet që figurojnë në këtë raport, i përkrahim me votë dhe dërgojmë tutje për shqyrtim në komisionet e përhershme dhe në raportin final që vjen në Komision, për në seancë kryesore.

**Kryetari**, shpjegimin e asaj se pse duhet hequr e sigurisë, që paska pastaj implikime dhe që u dashka ndryshuar ligje, nuk e bërë shpjegimin dhe nuk e kuptova pse? Sa i përket gradës, nuk mund të bëjmë krahasimin mes neve dhe Ministrisë por mes Agjencive simotra në vendet e rajonit dhe të botës. Pra është fjala për një Agjencion i cili është më ndryshe, ndërsa shpjegimi i juaj nuk qëndron. Ndërsa sa i përket kohës së implementim të ligjit, nuk është ekzagjerim zhvillimet globale në fushën

e sigurisë, pasi aktualisht në këtë Departament janë njerëz të trajnuar, kanë marrëdhënie të shkëmbimit të informacioneve, ndërsa insistimi për të bërë një shkëputje, duke u thirrur në barazi, Nënkrjetar Dugolli, në ushtri nuk ka të barabartë, janë gradat. Njerëzit edhe në fushën civile nuk janë të barabartë, thirrja e juaj për barazi është populliste, por tek Agjencioni që është shumë i rëndësishëm nuk mund të thirremi në barazi, ka arkiva ka raporte dhe janë njerëz që njihen mes veti, ndërsa të shkojmë dhe të ju themi do ti sjellim disa të ri, këtu nuk duhet të bëjmë politik. Antoni e shpjegoi në mënyrë profesionale dhe nuk duhet të insistojmë shumë, në këto dy amendamente dhe nuk do ta kenë mbështetjen e Komisionit. Pastaj do të na bëjë telashe, për ecjen para për disa ligje. Nëse mundesh argumentoma mirë dhe nuk kisha dashur të prishte konsensusi për një çështje që shihet, pasi këta njerëz janë profesionist.

**Anton Quni**, theksoi se si ish-ushtarak, nëse e ka përball një ekspert të fushës së arsimit, ekonomistit do duhej të bindeshim fakteve. Por detyrohet që të thotë, se ka eksperiencë dhe 8 vite edukim ushtarak, komandant i njërive gjatë çlirimit të Kosovës 1998-1999, detyra të ndryshme TMK/FSK, ish-këshilltar i Presidentit të Kosovës për siguri nacionale, pesë herë deputet në Parlamentin e Kosovës dhe gjithnjë anëtar i Komisionit për Siguri, Ministër i Mbrojtjes, do të kërkoja nga kolegët e mi, që të gjitha këto që po i kërkoj, duhet me i pasur në konsideratë, pasi nuk po flasim për politika të partive, por për politika të mbrojtjes dhe për çështje nacionale. Në lidhje me emërtimin, duhet të shikohet në fjalorin se si definohet siguria, dhe si definohet inteligjenca. Siguria është një termë më gjithëpërfshirës, ndërsa inteligjenca është pjesë e sigurisë, përderisa është sponsorizuar, se ky agjencion merret edhe me çështjet e sigurisë së mbrojtjes, inteligjenca brenda mbrojtjes është nivel më i ulët. Besoj se nuk ka më shumë ta elaborojmë, se çfarë është siguria dhe çfarë është inteligjenca. Sa i përket gradës dhe ristrukturimi, i nderuar z.Dugolli, në momentin që Ministri ia propozon Kryeministrit, miratohet nga Presidenti, që të ketë reduktim të gradave në të gjithë zinxhirin komandues. Ajo rregullore ose ligj që do të miratohet, do ti përfshinë drejtuesin e këtij agjencioni, por mos ta bëjmë këtë punë pa u miratuar struktura e re, pra jemi duke folur për situatën aktuale, nuk po flasim me supozime. Pajtohem që është një numër i fryrë dhe i ekzagjeruar i kadrove të larta, por në momentin që reduktohet me Drejtorinë dhe agjencionet e tjera jemi në rregull, por ky hap është i dukshëm. Aspekti tjetër, thirrja në barazi, tani të rrezikohet siguria nacionale në emër të barazisë, nuk ka kuptim. Këtu është mirë e theksuar, se të gjithë aplikojnë edhe zyrtarët që janë brenda Drejtorisë së Inteligjencës aplikojnë barabar me të gjithë të interesuarit. Si arrihet deri te Drejtuesi i Agjencionit? Komandanti i FSK-së, ka nën komandë të gjithë zyrtarët e FSK-së me rangje dhe grada të ndryshme, do duhej të ulej me Ministrin e Mbrojtjes, pa i lënduar kapacitete dhe misionet, do duhej të vinin në një përfundim të përbashkët, cili do të ishte individ i mirë me thirrje me gradë, me përgatitje që nuk e lenë keq një pozicion dhe të përmbushej kjo detyrë. Kjo detyrë nuk është e rezervuar për askënd dhe është e rezervuar për atë që i plotëson kriteret, dhe është i pranueshëm për nivelin e Komandantit dhe Ministri dhe mbetet në diskrecionin e Ministrit dhe Komandantit të FSK-së, se si një Drejtori shuhet dhe si ngritet një Agjencion, pra këto gjëra shkojnë me një matriks, e cila e koordinon personelin, infrastrukturën, ligjore, fizike, me rregullore dhe me kalimin e detyrave. Duke u shuar Drejtoria, ngritet Agjencioni, pa e rrezikuar vazhdimësinë dhe jo me krijuar vakum.

**Dimal Basha**, theksoi se sa i përket emërtimit, nuk është problem i madh, sa për çështje teknike, kur nuk kalon në grup punues, është mirë të dorëzohet si amendament dhe pastaj e votojmë, amendament për amendament, pastaj shkon në Kuvend me ose pa miratimin e Komisionit, kjo ka qenë rruga më e mirë për propozimet e kolegut deputet. Sa i përket kualifikimet, mendoj që kjo është substanciale, kurse tek dispozitat kalimtare, mendoj që shqetësimi është i arsyeshëm dhe më vjen keq që nuk kam qenë pjesë e grupit punues, pasi thotë që brenda dymbëdhjetë muajve të hyjë në fuqi ligji, ku fillon AISM-ja me qenë funksionale, kurse Drejtoria pushon së funksionuari.

**Anton Quni**, këtu paraqiten si rekomandime të Komisionit, pro nuk janë të grupit punues. Unë nuk kam amendament pasi e përkrah projektligjin siç është paraqitur nga sponsorizuesi.

**Enver Dugolli**, shtoi se vakum nuk ka, pasi në FSK, punët që i kryen kjo Drejtoria i kryen G2.

**Hisen Berisha**, kujdes se je duke folur para ushtarakëve dhe është jo profesionale.

**Enver Dugolli**, të gjitha amendamentet që i kemi bërë, i përkrahim, por vendimmarrja këtu ka me votë dhe këto amendamente duhet të votohen. Nuk ka shpëputje në asnjë moment, as nuk ka rrezikim të sigurisë. Drejtoria e AISM-së, emërohet brenda tridhjetë ditë që do të thotë që fillon funksionalizimi i saj dhe sigurisht ata që janë brenda kanë përparësi se sa ata që synojnë të vijnë.

**Anton Quni**, lidhur me deklarimin e z.Dugolli, që e përmendi për së dyti herë funksionin G2. Një pjesë e anëtarëve të Komisionit nuk e kuptojnë çfarë është G2. Në hierarkinë ushtarake, në nivelet më të ultë të njësive është S2( Section 2), që do të thotë nivele më të ultë taktike, kompanitë, batalion. Nivel më të lartë, brigadë, regjiment, korpus, divizion përdoret emërtimi G2, pra janë njerëz të profesioneve të ndryshme, që merren me sigurinë e informatave apo mbrojtjen e informatave dhe në nivelin më të lartë të hierarkisë ushtarake e përdorin J2, që do të thotë që janë grupe të profileve të ndryshme, si lufta speciale, propaganda, komunikimi strategjik, inteligjenca artificiale etj. Kur flasim për G2 është nivel taktik dhe nëse flasim për agjencion është dallim shumë i madh, Drejtoria e tanishme kanë marrëveshje bilaterale me partner në shkëmëbimin e informatave, që nuk e kanë të drejtën udhëheqësit e G2. Niveli i Agjencionit kanë komunikim të vazhdueshëm që janë të rregulluara me ligj, procedura dhe marrëveshje dhe një partner nëse e ka një informatë sensitive për çështjen e sigurisë nuk e ndan me G2, pasi punon me zyrtar të verifikuar. Informatat që vijnë nga nivelet e larta, janë të pakuptueshme për nivelin G2 dhe nuk ju hynë në punë. I kish lutur kolegët që të kenë konsideratë, pasi nuk mundet me ndodhë që të mbyllet Drejtoria, janë kompjuterët, softverët, arkivat, data bazat, të qëndrojnë një muaj dhe vjen një drejtor i ri, që nuk e pret askush në zyrë që t'ia dorëzoj detyrën, janë dokumente të klasifikuara, duhet një kohë e mirë që të kalon drejtoria aktual me Drejtorin e ardhshëm të Agjencisë.

**Hisen Berisha**, e para me çfarë pajtohem është që gjithmonë në strukturë të Forcës, ka pasur grada të nivelit të lartë dhe të fryra, nëse e krahasojmë me numrin e forcave. A ka pasur nevojë për reformim, sigurisht që po. Por brenda ka qenë një proces i largimit të atyre gradave që kanë pasur trashëgimi, qoftë nga UCK-ja, tash janë plotësuar kushtet për të bërë një reformë në gradat e larta. Unë kam shërbyer në Prilep të Maqedonisë, gjashtë mijë ushtar kanë qenë, të gjitha gjinitë, me përjashtim të forcave ajrore dhe Komandanti i garnizonit ka qenë nënkolonel.

Mbrojtja menaxhohet kontest më të gjerë të sigurisë, sigurinë e cenon shumë fusha të tjera. Sa i përket civilëve në forcë, janë në emër të ekspertizës, prandaj ka qenë ekuivalencë në pagë dhe në rangje, ndërsa deri kur do të jenë, është çështja e vlerësimit në ministri. Sa i përket barazisë në aplikim, në forcë nuk ka barazi në aspektin hierarkik, por barazia është në kontekst të drejtave në nivelin ku është. Ndërsa sa i përket dispozitave kalimtare, e kam bërë të ditur qysh në fillim, çështja e emërimit, gradës etj., janë tjetër temë, ndërsa dispozita kalimtare siç janë e ruajnë vazhdimësinë dhe nuk krijojnë vakancë dhe këto janë dispozitat që flasin qartë. Z.Dugolli edhe kur kemi dashur të bëjmë Ligjin për Komisionerini, ka pasur qëndrim kundër Komisionerit, pasi është thirrur në Ombutspersonin dhe mundësinë e përfshirjes së një zëvendësi. Po ashtu sa i përket Projektligjit për AISM-në, jemi shkuar në Shqipëri në vizitë studimore dhe na është thënë vetëm harmonizoni gjuhën pasi ligji është në rregull. Në raportin e prezantuar për propozim amendamentet thuhet që, grupi punues për shqyrtimin e Projektligjet, nëse i prezanton të tjera nuk është qëndrim i grupit që jemi pajtuar, nga ka ardhur kjo formë e të shkruarit të kësaj se di! Uroj të mos jetë si vota e kontrabanduar për votimin e Komisionerit Parlamentar të FSK-së. Nuk duhet të lëndohet struktura aktuale e inteligjencës në fushën e mbrojtjes, dispozitat kalimtare që janë, këto i kemi punuar bashkë me NATO-n, për kalimin e TMK-së në FSK. Është punuar me partnerët ndërkombëtar në këtë fushë, andaj është mirë që mos të lëndohet kjo strukturë, pasi siç parashihet në projektligj e rregullon mirë aspektin e tranzicionit. Tani e kemi mundësinë e zhvillimit të kapaciteteve të forcës dhe e kemi mundësinë të kalojmë draftin vetëm me korrigjimet gjuhësore.

**Enver Dugolli**, për të qenë korrekt, z.Quni ka qenë i rregullt në takimet e grupit punues, ndërsa ju z.Berisha, në disa raste jeni vonuar ose ke dalë më herët. Por sa i përket tranzicionit, ne e kemi shembullin më të mirë, jemi duke ndërtuar institucionet, e kemi pasur rastin e formimit të FSK-së. Është shuar TMK-ja, dhe më pas është krijuar FSK-ja, prandaj të jeni të bindur që detyrat që i kryen Drejtoria nuk do të mbesin keq, pasi ideja është krijimi i kundër inteligjencës, të cilën aktualisht nuk e ka kjo Drejtoria Tutje kërkoi që të hidhet në votim raporti me propozim-amendamente pasi kemi edhe projektligje të tjera.

**Anton Quni**, lidhur me fjalën e z.Dugolli, theksoi se nuk është ashtu siç u prezantua, pasi i njeh personalisht përgjegjësitë që i kanë si Drejtoria, por të hyjnë në detaje, do të duhet të ndaj informata që janë të klasifikuara.

**Kryetari**, propozoi mbylljen e takimit për media si deh personat që janë prezent në takim përveç anëtarëve të Komisionit.

*Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe mbrojtjes në këtë pikë të rendi të ditës me pesë (5) vota për, Enver Dugolli, Shqipe Mehmeti Selimi, Mefail Bajqinovci, Arbër Rexhaj, Dimal Basha dhe tre (3) vota kundër, Bekë Berisha, Hisen Berisha, Anton Quni dhe 1 (një) abstenim, Erxhan Galushi nxori këtë:*

**REKOMANDIM**

*Raporti me propozim amendamente për Projektligjin Nr.08/L-225 për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes procedohet tek komisionet e përhershme të Kuvendit për vlerësim sipas procedurës.*

### **3. Shqyrtimi i raportit me propozim amendamente për Projektligjin Nr. 08/L-261 për mbrojtje nga zjarri.**

**Kryetari**, si Komision funksional për shqyrtim të këtij Projektligji kemi formuar grupin punues, raporti me propozim amendamente e kemi pranuar. Fillimisht ia kalojë fjalën z.Arbër Rexhaj, kryesues i grupit punues.

**Arbër Rexhaj**, theksoi se në cilësinë e kryesuesit të grupit punues për këtë Projektligj, këto janë propozim amendamente e dalura nga grupi punues, të cilat beso i keni parë tashmë dhe mund ti lexojmë një e nga një , nëse është e nevojshme.

**Kryetari**, atëherë i hedhim në votim propozim amendamentet për këtë Projektligj.

*Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe mbrojtjes, në këtë pikë të rendit të ditës me vota unanime nxori këtë:*

#### **REKOMANDIM**

*Raporti me propozim amendamente për Projektligjin Nr.08/L-261 për mbrojtje nga zjarri miratohet dhe procedohet tek komisionet e përhershme të Kuvendit për vlerësim sipas procedurës.*

### **4. Shqyrtimi i raportit me propozim amendamente për Projektligjin Nr. 08/L- 267 për letërnjoftimin.**

**Kryetari**, gjithashtu edhe këtë Projektligj, në cilësinë e Komisionit funksional, kemi formuar grupin punues, i cili ka punuar dhe tani ka paraqitur propozim-amendamentet.

**Dimal Basha**, në cilësinë e kryesuesit të grupit punues, theksoi se i kanë adresuar të gjitha shqetësimet e palëve që kanë qenë në grup dhe nuk ka pasur asnjë vërejtje nga palët, andaj propozoi miratimin e propozim amendamenteve të propozuara.

**Kryetari**, atëherë nëse nuk ka dikush që e dëshiron fjalën, e hedhim në votim.

*Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, në këtë pikë të rendit të ditës me vota unanime nxori këtë:*

#### **REKOMANDIM**



*Raporti me propozim amendamentet për Projektligjin Nr. 08/L-267 për letërnjoftimin miratohet dhe procedohet tek komisionet e përhershme për vlerësim sipas procedurës.*

#### **5. Shqyrtimi i raportit me propozim amendamente për Projektligjin Nr. 08/L-274 për Shërbimet Private të Sigurisë.**

**Kryetari**, gjithashtu edhe për këtë Projektligj, në cilësinë e Komisionit funksional, jemi ngarkuar dhe kemi formuar grupin punues i cili ka sjellë raportin me propozim amendamente. Fjalën ia kaloi kryesuesit të grupit punues z.Dimal Basha.

**Dimal Basha**, në cilësinë e kryesuesit të grupit punues për këtë Projektligj, theksoi se edhe për këtë Projektligj janë adresuar të gjitha shqetësimet dhe në bashkëpunim me grupin kemi ardhur me këto propozim amendamente, të cilat propozojmë të miratohen dhe procedohen tutje.

**Kryetari**, hedhim në votim raportin me propozim amendamente.

*Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, në këtë pikë të rendit të ditës me vota unanime nxori këtë:*

#### **REKOMANDIM**

*Miratohet raporti me propozim amendamente për Projektligjin Nr.08/L-274 për Shërbimet Private të Sigurisë dhe procedohet tek komisionet e përhershme të Kuvendit për vlerësim.*

#### **6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr.08/L-296 për të huajt.**

**Kryetari**, lidhur me këtë pikë, ju njoftoj që jemi të ngarkuar si Komision funksional për shqyrtimin e këtij Projektligji. Projektligji për të Huajt është i rëndësishëm pasi ka për qëllim rregullimin e hyrjes, kalimin transit, hyrjes dhe daljes së të huajve në territorin e Republikës së Kosovës, propozoj miratimin e tij në parim. Gjithashtu propozoj formimin e grupit punues për shqyrtimin e tij dhe nëse i keni propozimet, urdhëroni.

*Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe mbrojtjes, në këtë pikë të rendit të ditës me vota unanime nxori këtë:*

#### **REKOMANDIM**

*Në bazë të Nenit 74.2. të Rregullores së Kuvendit, Projektligji Nr. 08/L-296 për të Huajt i plotëson kushtet e parapara me Nenin 71 të Rregullores së Kuvendit për tu proceduar për shqyrtim të parë në seancë plenare dhe i rekomandon Kuvendit, miratimin e tij në parim.*

**Kryetari**, atëher hedhim në votim edhe grupin punues për këtë Projektligj.

*Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, në këtë pikë të renditë ditës me vota unanime nxori këtë:*

#### VENDIM

*Formohet grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit Nr.08/L-296 për të huajt me këtë përbërje: Mefail Bajqinovci-kryesues, Shqipe Mehmeti Selimi dhe Rashit Qalaj-anëtar.*

### **7. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes kornizë ushtarake ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë.**

**Kryetari**, si Komision jemi ngarkuar për shqyrtimin e këtij Projektligji, për ratifikimin e marrëveshjes ushtarake mes Kosovës dhe Turqisë. Elementet kryesore e kësaj marrëveshjes kornize kanë të bëjë me stërvitjen dhe edukimin ushtarak, arsimim ushtarak, qendra stërvitore dhe, pjesëmarrja e ndërsjellë në ushtrime/trajnime të përbashkëta, dhe vizitat e kontaktet ndërmjet Forcave të Armatosura; Shkëmbimi i inteligjencës ushtarake; Mjekësia ushtarake dhe shërbimet shëndetësore. Ky Projektligj miratohet vetëm me një lexim dhe propozoi që ne si Komision ta rekomandojmë miratimin e këtij nga Kuvendi.

Para se ta hedhim në votim a e dëshiron dikush fjalën?

*Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, në bazë të nenit 83.5 të Rregullores së Kuvendit. Lidhur me Projektligjin Nr.08/L-297 për ratifikimin e Marrëveshjes kornizë ushtarake ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, i paraqet Kuvendit këtë:*

#### REKOMANDIM

*Të miratohet Projektligji Nr. 08/L-297 për ratifikimin e Marrëveshjes kornizë ushtarake ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë.*

### **8. Formimi i grupit punues për hartimin e Rregullores së punës për Komisionerin Parlamentar për FSK.**

**Kryetari**, lidhur me ushtrimin e mandatit nga Komisioneri Parlamentar për FSK-në, Ligji, përcakton se Kuvendi inicion dhe miraton Rregulloren e Punës së Komisionerit.

Prandaj lidhur me hartimin e kësaj Rregullore, propozoi të formohet grupi i punës. Grupi i Punës, do të jetë përgjegjës për draftimin e kësaj Rregullorja dhe pastaj e sjellin në Komisionin.

Unë propozoi Anton Qunin, nëse jeni dakord për kryesues të grupit, pasi ka qenë i përfshire nga fillimi në këtë proces edhe nga legjislativat e kaluara. Po ashtu anëtar i grupit të punës do të jete edhe Komisionerja znj. Remzie Zeqiraj. Por edhe ndonjë deputet tjetër duhet prandaj a ka propozime?

*Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes në këtë pikë të rendit të ditës me vota unanime nxori këtë:*

#### VENDIM

*Formohet, Grupi i Punës për hartimin e Rregulloren e Punës së Komisionerit Parlamentar të FSK-së me këtë përbërje: Anton Quni- Kryesues; Enver Dugolli; Hisen Berisha dhe Komisionerja znj. Remzije Zeqiraj, anëtar*

#### **9. Të ndryshme.**

Nëse nuk a çështje për të diskutuar e konsideroj takimin e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 13:10

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i Komisionit.**

**Bekë Berisha,**  
**Kryetar i Komisionit**

---

